



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 2095 / Prot. 1

Tiranë, më 23.10.2024

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës tuaj datë 9.10.2024

QENDRA "RES PUBLICA"

AV. DORIAN MATLIJA, DREJTOR EKZEKUTIV

Adresa: Blv "Gjergj Fishta", Nd. 24, H. 3, Ap. 7, Tiranë

Email: qendra.respublica@gmail.com

I nderuar Z. Matlija,

Në vijim të kërkesës tuaj, datë 9.10.2024, protokolluar me tonën nr. 2095, datë 9.10.2024, ju vëmë në dispozicion kopjet e dokumentacionit të kërkuar nga ana juaj.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Edmond VERCANI



ALBSIG SH.A.
Nr. 700 Prot.
Date: 14/06/2021

KOMISIONI I PAVARUR
I KUALIFIKIMIT
Nr. 4547/1
Datë 18.6.2021

MARRËVESHJE SPONSORIZIMI

Në Tiranë, sot në datën 14/06/2021, lidhet kjo Kontratë Sponsorizimi (referuar këtu e në vijim si "Kontrata") midis Palëve:

PALET:

Kompanisë së Sigurimit "ALSIG" Sh.a, shoqëri aksionare, themeluar sipas legjislacionit shqiptar, me seli qendrore në adresën: Rruga e Barrikadave, Tiranë, Shqipëri, me NIPT Nr. K42108801C përfaqësuar ligjërisht z. Muharrem Bardhoci, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, mbajtes i Kartes së Identitetit Nr. 03371592, (Referuar këtu e në vazhdim si "Sponsorizuesi")

dhe

Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, person juridik publik, me adrese: "Rruga e Kavajës", godina e ish- "Lidhja e Shkrimtarëve dhe Artistëve", Tiranë, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Edmond Verçani (në vijim referuar si "Përfituesi"),

dhe

Subjekti "THODHORI KAMBERI", me adresë: Rruga "Pjetër Budi", Tiranë, Albania, regjistruar pranë QKB-së Tiranë, me NIPT L81630005A, me emrin tregtar "LUX TRAVEL AGENCY", mbajtes i Kartes së Identitetit me nr. Personal J10618107T, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar (në vijim referuar si "Ofruesi i Shërbimit").

Së bashku referuar si "Palët" dhe individualisht si "Pala"

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

NENI 1

OBJEKTI DHE BAZA LIGJORE

Objekti i kësaj Kontrate është financimi dhe mbështetja me fonde nga "Sponsorizuesi" të "Përfituesi" për realizimin e Aktivitetit "Strategy Meeting", të organizuar nga pala Përfituese, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

Për interpretimin e kësaj Kontrate do të jenë të aplikueshëm nenet 659-704 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë si dhe ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 "Për sponsorizimet" i ndryshuar.

Ky bashkëpunim kryhet me qëllim mbështetjen e aktivitetit të specifikuar në programin/projektin bashkëlidhur, "Strategy Meeting".

NENI 2

KOHËZGJATJA E KONTRATËS

Kjo kontratë hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të saj nga Palët dhe përfundon me realizimin e të gjitha aktiviteteve të projektit, brenda një afati 1 (një) mujor. Kontrata ka efekt që nga data e nënshkrimit dhe përfundon brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i saj.



Aktiviteti "Strategy meeting" finalizohet me përmbylljen e tij.

Në çdo rast palët ruajnë të drejtën e përfundimit të kontratës, duke njoftuar paraprakisht me shkrim njëra-tjetrën 5 ditë përpara datës kur do të konsiderojë të përfunduar kontratën.

NENI 3

SHUMA E SPONSORIZIMIT TË AKTIVITETIT

Sponsorizuesi do të mbështesë me sponsorizim Komisionin për organizimin e Aktivitetit "Strategy Meeting".

Shuma e sponsorizimit do t'i paguhet kompanisë "LUX TRAVEL AGENCY", për shërbimin që do të kryejë për llogari të Komisionit, përsa i përket:

- Udhëtimit dhe akomodimit të gjithë stafit të Komisionit për 3 ditë dhe 2 net;
- Organizimit të workshop-it në katër sesione (në dy ditë) në sallën e konferencave të njësisë akomoduese;

Pagesa do të kryhet në llogarinë bankare të vendosur në nenin 4 të kësaj kontrate.

NENI 4

TE DREJTAT DHE DETYRIMET E PALEVE

Kompania e Sigurimit do të sponsorizojë vlerën e faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimit në shumën 3000 (tremije) Euro, për organizimin e aktivitetit "Strategy Meeting" dhe të zhvilluar nga Komisioni, në llogarinë si vijon:

Emri i Bankës: CREDINS BANK

Nr. i llogarisë EUR: 0000 105 9488

IBAN: AL02 2121 1298 0000 0000 0105 9488

SWIFT: CDISALTRXXX

Ofruesi i Shërbimit "LUX TRAVEL AGENCY" i paraqet Sponsorizuesit faturën përkatëse për shlyerjen e detyrimit për shërbimin e ofruar për realizimin e aktivitetit.

NENI 5

KOMUNIKIMI MIDIS PALËVE

Për çështjet që i takojnë objektit të kësaj Kontrate, palët duhet t'i përgjigjen njëra-tjetrës me shkrim brenda 3 ditëve kalendarike nga kërkitimi i tyre, përmes personave të caktuar për mbajtjen e kontaktit, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i informacioneve të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm:



Për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit: Z. Edmond Verçani
Pozicioni: Sekretar i Përgjithshëm
E-mail: info@kpk.al

Për ALBSIG SH.A:

Z. Muharrem Bardhoci
Pozicioni: Drejtor i Përgjithshëm
E-mail: mbardhoci@albsig.al

Për "Lux Travel Agency":

Z. Thodhori Kamberi
Pozicioni: Administrator
E-mail: luxtravels@gmail.com
Nr. cel: 0694301620

NENI 6

PRONËSIA E PRODUKTEVE TË AKTIVITETIT

Të gjitha materialet e prodhuara në kuadër të këtij aktiviteti mbeten në Pronësi të Komisionit. Sponsorizuesit gëzojnë të drejtën të të prodhuara në kuadër të këtij aktiviteti për qëllim PR dhe komunikim.

NENI 7

KONFIDENCIALITETI DHE MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Konfidencialiteti nënkupton që çdo lloj informacioni, të dhëna nga njëra palë për palën tjetër, përfshirë informacionet financiare lidhur me kontratën. Keto informacione duhet të konsiderohen si reptesisht konfidenciale nga pala që i merr dhe nuk duhet të behen publike tek palet e treta ose të kopjohen nga pala përfituese, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është e nevojshme për zbatimin e kushteve të kësaj marrëveshjeje ose në rast se kjo miratohet nga pala derguese.

Palet bien dakord dhe konsiderojnë si reptesisht konfidenciale çdo apo të gjitha informacionet të komunikuar mes tyre në lidhje me aktivitetin ekonomik të tyre, produktet, shërbimet dhe të mos bejnë publike informacione të tilla, teresisht apo pjesërisht për çdo person të tretë si dhe të mos përdorin këtë informacion për ndonjë qëllim tjetër të ndryshëm nga sa përcaktohet në këtë marrëveshjeje.

Gjithashtu, palet garantojnë që për çdo të dhënë personale që do të ketë dijeni me anë të kësaj kontrate, do të respektojnë kriteret që parashikon Ligji Nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale". Përfituesi garanton që të gjithë punëmarresit e tij do të respektojnë konfidencialitetin gjatë periudhës së kontratës. Shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen do t'i japë të drejtën Bankës të përfundojë menjëherë këtë Kontratë duke i dhënë Përfituesit të shërbimit një njoftim me shkrim, pa cenuar kjo të drejtën e Bankës të kërkojë nga Përfituesi zhdëmtim të dëmit të shkaktuar. Detyrimi i ruajtjes së sekretit sipas këtij neni do të vazhdojë për një afat të përcaktuar pas përfundimit të kësaj Kontrate.

NENI 8

VLEFSHMËRIA E KONTRATËS

Asnjë ndryshim i neneve të kësaj Kontrate nuk do të ketë efekt, përveç rastit kur konfirmohet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët dhe është e specifikuar si pjesë e kësaj Kontrate;

Në rast se një ose më shumë kushte të kësaj Kontrate do të konsiderohen të pa gjishme, kjo e metë nuk do të cënohet tërësinë e saj e cila do të jetë e vlefshme për dispozitat e mbetura. Kontrata firmoset nga të trija palët në këtë mënyrë:

- a. firma e përfaqësuesit në çdo faqe të Kontratës;
- b. emri i plotë dhe firma e përfaqësuesit në faqen e fundit të Kontratës;
- c. si dhe vula e shoqërisë në faqen e fundit.

NENI 9

KLAUZOLA E ANTIKORRUPSIONIT DHE MITMARËS

Pala Përfutuese deklaron dhe pranon se në datën e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate as ai vete dhe as drejtuesit e tij, apo personat e punësuar prej tij nuk kanë ofruar, premtuar, dhënë, autorizuar, kërkuar/ pranuar pagesa të padetyruara ose avantazhe të tjera të cdo lloji (dhe angazhohen që në të ardhmen të mos pranojnë apo të mos kryejnë asnjë prej këtyre veprimeve) lidhur me këtë kontratë dhe se kanë ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme, për të parandaluar nënkontraktorët, agjentët apo palë të treta të tjera, nën kontrollin e tij për të kryer të tilla veprime. Pala Përfutuese njihet dhe bie dakord se këto deklarime i përsërit gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj kontrate. Në rast mosrespektimi të këtij neni, pala që bie në dijeni të këtyre fakteve ka të drejtë të zgjidhë kontratën në mënyrë të menjëhershme dhe të kërkojë shpërblym për dëmin e shkaktuar.

NENI 10

FORCA MADHORE

Palët nënshkruese të kësaj kontrate nuk do të përgjigjen sipas kushteve të kësaj kontrate, deri sa nuk provohet e kundërta, për atë kohë sa ekzistojnë forcat madhore për të cilat duhet të njoftojnë njëra-tjetrën nëpërmjet email ose në mënyrë shkresore. Në rast se forca madhore do të veprojë më shumë se 50 ditë, atëherë kontrata do të quhet e prishur nga të dyja anët. Me forcë madhore do të kuptojmë të gjitha ngjarjet e paparashikueshme të cilat sjellin mosekzekutim ose vonesë në përmbushjen e detyrimeve nga secila palë e kontratës kur këto palë nuk janë në gjendje t'i shmangin këto ngjarje.

Në forcën madhore përfshihen:

- Aksidentet madhore, zjarr, përmblyje, tërmete, epidemi, shtrëngime të karantinës;
- Lufta, gjendje e luftës, shkatërrimet ose shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme;
- Forcë madhore të ndonjë natyre tjetër.

Në rast se verifikohet një ose disa nga situatat e mësipërme, palët duhet të vëndojnë përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme.

NENI 11

KLAUZOLA E KODIT TE ETIKES

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, pala kontraktore deklaron se është njohur me Kodin Etik të Komisionit dhe të palëve në këtë kontratë dhe pranon se ai/ata vetë, punonjësit e tij dhe nënkontraktorët e tij do të respektojnë këtë Kod gjatë gjithë ekzekutimit të kësaj kontrate. Palët kontraktore/dhënësi i shërbimit është njohur me faktin se çdo shkelje e rëndë apo e përsëritur (pavarësisht mungesës së njoftimit nga palët) e dispozitave të Kodit Etik të Komisionit dhe të kompanisë sponsorizuese dhe asaj ofruese e shërbimit, mund të rezultojë në zgjidhje të menjëhershme të kontratës nga pala që ka rënë në dijeni të faktit të shkeljes së Kodit Etik, prej palës tjetër kontraktore.

NENI 12

INFORMACIONI I KLASIFIKUAR/KONFIDENCIAL DHE KUADRI LIGJOR I ZBATUESHËM

Nëpërmjet nënshkrimit të kësaj kontrate në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë veprimtarinë e secilës palë kontraktore, palët deklarojnë se për çdo informacion që merr gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj mbi të dhënat e palëve në këtë kontratë nuk duhet dhe as do t'i përdorë ato për përfitime vetjake ose për të tretët jashtë institucionit/kompanisë të cilave u shërbejnë ose u kanë shërbyer.

Shkelja e këtyre detyrimeve pasqell pasojë ligjore për këdo që shkel ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe informacionin e klasifikuar/konfidencial/

NENI 13
DISPOZITAT E FUNDIT

Kjo kontratë përbën marrëveshjen e plotë të Palëve dhe përcakton në mënyrë ekskluzive afatet dhe kushtet lidhur me objektin e saj;

Sponsorizuesi është në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në rregulloret e brendshme të Sponsorizimeve në lidhje me konfliktin e interesave dhe deklaron se asnjë punonjës i palës përfituese nuk zotëron interes privat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me të;

Palët do të përpiqen t'i zgjidhin me mirëkuptim të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës. Nëse kjo nuk është e mundur, juridiksioni kompetent për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që burojnë nga ekzekutimi i kësaj Kontrate është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë;

Kontrata përpilohet në 4 kopje origjinale në gjuhën shqipe, ku secila palë mban 1 kopje dhe Sponsorizuesi 2 kopje. Pasi u lexua nga palët, nënshkruhet rregullisht prej tyre.

Kjo Kontratë nënshkruhet rregullisht nga përfaqësuesit e autorizuar të Paleve, sot më 14/06/2021.

SPONSORIZUESI

PERFITUESI

OFRUESI I SHERBIMIT

ALBSIG SH.A.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

LUX TRAVEL AGENCY

Z. Muharrem Bardhoci

Drejtor i Përgjithshëm




Z. Edmond Verçani

Sekretar i Përgjithshëm



Z. Thodhori Kamberi

Administrator





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 134/1 prot.

Tiranë, më 21.1.2022

Lënda: Kthim përgjigjeje

OPERACIONIT NDËRKOMBËTAR TË MONITORIMIT

Rruga e Kavajës, Godina e ish-“Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”

Tiranë

Të nderuar Vëzhgues Ndërkombëtare,

Në vijim të shkresës suaj nr. 16 prot, datë 17.1.2022, dëshirojmë të risjellim edhe një herë në vëmendjen tuaj se, aktiviteti i mbajtur në datë 29-30 shtator 2021 u realizua në kuadër të përmbylljes së punës 4 vjeçare të KPK-së, me fokus bilanci i arritjeve, analiza e problematikave dhe sfidat e së ardhmes.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, si çdo institucion tjetër ka një buxhet të miratuar vjetor sipas ligjit për Buxhetin e Shtetit. Ky buxhet është shumë i kufizuar dhe duhet të përballojë vetëm shpenzimet për pagat dhe nevojat vjetore për mallra, shërbime dhe mirëmbajtje në funksion të veprimtarisë që Komisioni kryen, që në buxhetin e shtetit definohet si aktivitet i vetëm ai i procesit të rivlerësimit kalimtar. Pra Komisioni nuk mund të sigurojë të ardhura të tjera dytësore pasi nuk kryen veprimtari tjetër përveç vettingut.

Duke qenë në kushtet e një buxheti minimal dhe pamundësisë për të pasur një zë të posaçëm për organizim eventesh në ligjin vjetor të buxhetit, Komisioni u përpoq që të përmbushë të gjitha nevojat e tij me ato fonde që kishte në dispozicion si dhe mendoi të siguronte donacione për zhvillimin e një aktiviteti, që nuk parashikohet si i tillë në buxhetin që atij i akordohet çdo vit.

Ky aktivitet është konsideruar i rëndësishëm dhe i domosdoshëm në kohën e zhvillimit të tij, duke patur parasysh të ardhmen e diskutueshme, si dhe në kontekstin e vendosjes së indekseve të matshëm për punën, jo vetëm të Komisionit në përgjithësi, por dhe të çdo komisionieri në veçanti, gjë që do e bënte më të lehtë parashikimin për vazhdimësinë e punës dhe vendosjen e objektivave, pavarësisht skenarëve të mundshëm. Për të mos cenuar buxhetin e shtetit për një aktivitet të paparashikuar nga ky i fundit, zgjidhja është gjetur duke marrë një donacion nga jashtë institucionit, përmes një aktamrrëveshjeje sponsorizimi nga kompania e sigurimit ku

Komisioni dhe çdo anëtar i tij, do të qëndronte i paimplikuar nga çdo pikëpamje e konfliktit të interesit apo e cenimit të imazhit institucional.

Dwshirojmw tw theksojmw se bazuar në legjislacionin e prokurimit publik procedurat e prokurimit, përzgjedhja e operatorit fitues dhe lidhja e marrëveshjes kuadër për sigurimin e shëndetit për KPK-në, nuk kryhen nga KPK, por një organ publik i specializuar, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara (ABP), i parashikuar shprehimisht me ligj si organ kompetent për zhvillimin e prokurimeve publike.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk luan asnjë rol dhe ka ZERO ndikim në këto procedura. Komisioni merr në rrugë zyrtare Marrëveshjen Kuadër të lidhur mes kompanisë fituese dhe ABP-së, njoftimin e kompanisë fituese, së bashku me dokumentet standarde të tenderit (DST) të miratuara nga kjo Agjenci, me të cilën Komisioni lidhi kontratën e siguracionit të shëndetit të personelit në 17 korrik 2020.

Duke pasur parasysh këto premisa ligjore u mendua se, marrja e një donacioni nga një palë e tretë private me të cilën KPK kishte një siguracion shëndeti në vitin 2020, si rezultat i procedurave të kryera nga ABP-ja, nuk do të ishte në kushtet e një konflikti interesi dhe nuk do të krijonte një perceptim të gabuar për imazhin e Komisionit, për aq kohë sa Komisioni dhe anëtarët e tij, nuk përfshihen në asnjë procedurë prokurimi publik.

Megjithatë, duke pasur parasysh qëllimin e reformës në drejtësi dhe rolin thelbësor që ka KPK në këtë proces, në kthimin e besimit të publikut tek institucionet përkatëse, KPK e vlerëson dhe i jep të drejtë shqetësimit tuaj. Në çdo rast e çdo rrethanë, KPK do të konsultohet nga afër me ju, përpara se të ndërmarrë iniciativa të tilla, pavarësisht se kanë të bëjnë ekskluzivisht me punën dhe funksionimin e KPK-së. Mendimi juaj i specializuar në këtë këndvështrim do të jetë një ndihmë e çmuar për institucionin tonë.

Duke ju falënderuar mirëkuptimin dhe mbështetjen e vazhdueshme tuajën në këtë proces, ju shpreh konsideratën timë të lartë për suportin dhe ekspertizën tuaj.

KRYETARI
Pamela Qirko

